



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SJ & I P-A

Nr. 926 Prot.

Tiranë, më 23.05.2025

**Lënda:** Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**  
**Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë**

*Të nderuar,*

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për:

- **Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I P-A**

**I. KRITERET PËR KANDIDATËT**

***I.1. KRITERE TË PËRGJITHSHME:***

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

***I.2. KRITERE TË VEÇANTA:***

1. Të ketë kryer arsimin e lartë, në fushën e Drejtësisë, së paku në nivelin “Master i Shkencave” ose diplomë e programeve të integruara (DIND) sipas ligjit 80/2015.
  - 1.1. Në rast se studimet janë kryer në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të ketë përvojë pune prej së paku 10 vitesh në fushën e studimit.
3. Të ketë përvojë pune prej së paku 10 vitesh në pozicione drejtuese.
4. Të ketë marrë pjesë në trajnime, kualifikime të ndryshme në fushën e menaxhimit ose administrimit (në arsim përbën përparësi);
5. Të njohë legjislacionin dhe procedurat e tjera administrative e juridike;

6. Të jetë njohës shumë i mirë i natyrës së punës së drejtorisë përkatëse.
7. Të ketë aftësi shumë të mira në komunikim, planifikim, organizim dhe menaxhim.
8. Të jetë njohës i një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
9. Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit, si dhe programet bazë Microsoft Office.

***Kritere kualifikuese përbëjnë kriteret e përgjithshme, së bashku me kriteret e veçanta, pikat 1-4. Mosplotësimi i këtyre kriterëve përbën shkak për skualifikim të kandidaturës.***

## **II. PËRMBAJTJA E DOSJES (DOKUMENTACIONI)**

Sa më sipër, kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ-P/A:

1. Letër motivimi për pozicionin e punës për të cilin konkurron;
2. Fotokopje të noterizuar të diplomës që vërteton kryerjen e arsimit të lartë. Për kandidatët që kanë kryer studimet jashtë vendit, dokumenti për njohjen dhe njehsimin e diplomës;
3. Fotokopje të noterizuar e listës së notave;
4. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës, që vërteton përvojën në punë;
5. Jetëshkrimi (CV) në gjuhën shqipe, ku të jetë përfshirë edhe adresa e postës elektronike, i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
6. Letër reference/vlerësimi pune nga punëdhënësi i fundit;
7. Dokumente të tjera plotësuese si: fotokopje e noterizuar e çertifikimeve, dëshmime apo diplomave të trajnimeve ose kualifikimeve pasuniversitare në fushën përkatëse, nëse ka;
8. Dëshmi të mbrojtjes së një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), mbi bazën e provimeve ndërkombëtare, ose institucione shtetërore apo private të akredituara sipas legjislacionit në fuqi.
9. Kopje e kartës së identitetit;
10. Vetë deklaram i gjendjes gjyqësore, sipas formatit bashkëngjitur;
11. Vetë deklaram mbi parandalimin e konfliktit të interesit për vendin vakant të shpallur.
12. Dëshmi e gjendjes mjekësore.

## **III. DORËZIMI I DOSJES, AFATI DHE NJOFTIMET**

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, dorëzohet fizikisht, nga vetë kandidati, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I P-A në Universitetin e Arteve, nga data **02.06.2025** deri më datë **16.06.2025**, ora **14:00**.

Vetëm kandidatët të cilët do të plotësojnë kriteret kualifikuese, do të njoftohen për të marrë pjesë në fazën e mëtejshme.

Kandidatët e kualifikuar do të informohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ & I P-A përmes postës elektronike, si dhe për çdo pyetje apo paqartësi, çdo ditë, nga ora 08:00 deri në 14:00.

#### IV. VLERËSIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët të cilët do të vazhdojnë në fazën e mëtejshme të konkurrimit do të vlerësohen si më poshtë:

- Vlerësimi i testit me shkrim – deri në 60 pikë. Kandidati duhet të marrë minimalisht 30 pikë në mënyrë që të vazhdojë me vlerësimin e jetëshkrimit dhe intervistën e strukturuar me gojë.
- Vlerësimi i jetëshkrimit (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimit, vlerësimin e përvojës dhe vlerësimin e trajnimeve e kualifikimeve të lidhura me fushën – deri në 15 pikë.
- Vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë, që lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës – deri në 25 pikë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**REKTORI**  
**Prof. Dr. Erald Bakalli**